

NË EMER TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Islam Thaçi, me sekretaren juridike Rafete Syla, në lëndën penale kundër të pandehurit M.S.,për shkak të 2 (dy) veprave penale: mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve ngs neni 374 paragrafi 1 dhe posedim të paautorizuar i narkotikëve, supstanca psikotrope ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 të KPRK-, të cilin e ka mbrojtur, av. S.R. nga ..., me autorizim, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore -Departamenti i Krimeve të Rënda në Gjilan, PP.I.nr.17/18, të datës 05.02.2018, të cilin e përfaqësonte prokurori i shteti Agron Uka, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar më 09.02.2018, shpalli publikisht,ndërsa më 12.02.2018, hartoi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.S. nga babai A. dhe nëna Z., e lindur Sh., i lindur më data e lindjes... në ..., ku edhe jeton në rr. “ ... ”, nr. ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa punësuar, i martuar, babë i 2 (dy) fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

I.

Sepse në kohë të pacaktuar më parë, i pandehuri në shtëpinë e tij në rr. “ ... ” ne ..., pa autorizim dhe ne kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët, ka mbajtur në pronësi armë të zjarrit, ashtu që më datë 11.01.2018, rreth orës 07:00, nga Njësi i Hetimeve Rajonale në Gjilan, janë sekuestruar pistoleta e markës “Ecol TunaP.A.K”, pa numër serik , e kalibrit 6mm, dy fishekë të kalibrit 7.62mm dhe 21 fishekë të pushkës së gjuetisë të kalibrit 12 mm.

Me çka ka kryer veprën penale, mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve ngs neni 374 psrgsrfi 1, të KPRK-së.

II.

Më datën, kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitivin e parë (I) të këtij aktgjykimi, i pandehuri pa autorizim ka poseduar substancë narkotike të llojit marihuanë, e cila është e shpallur me ligj si narkotikë i rrezikshëm, ashtu që me rastin e kontrollimit të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse në shtëpinë e tij –mbi kuzhinë në një pako të cigareve ” ... ” është gjetë substanca narkotike e llojit “Marihuanë “ në peshë rreth 9.9 gram,e cila substancë është sekuestruar nga ana e Policisë së Kosovës –NJHR në Gjilan.

Me çka ka kryer veprën penale posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e sipërthekësuar ligjore si dhe neneve 4, 7,41, 45,49,50,51, 52, 73, 74, 75, 76 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPP-së, të pandehurin, e

G J Y K O N

Për veprën penale nga dispozitivi I, i cakton dënim me gjobë në shumën prej 600 €, (gjashtëqind) Euro, për veprën penale dispozitivi II, i cakton dënim me gjobë në shumën prej 300€ (treqind)Euro dhe dënim më burg në kohëzgjatje prej 120 (njqind e njëzetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri brenda periudhës verifikuese prej 2 (dy) viteve nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do t'i revokohet,

Gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 80 parag.1 dhe 2 nënparag.2.5 të KPRK-së, të pandehurit i shqipton dënim unik me gjobë në shumën prej 900€ (nëntëqind) Euro, në të cilin dënim në pajtim me nenin 83 të KPRK-së, koha e kaluar në arrest shtëpiak nga data 11.01.2018 e deri më 09.02.2018, i'u është llogaritur në shqiptimin e dënimit me gjobë, ashtu që i pandehuri pjesën e mbetur të dënimit me gjobë në shumën pre 300€ (treqind) Euro do ta paguaj në afatin prej 3 muajve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse i pandehuri nuk mundet apo nuk dëshiron që ta paguaj dënimin me gjobë në shumën si më lartë, atëherë të njejtit gjykata dënimin me gjobë do t'ia zëvendësoj në dënim me burg, duke llogaritur një ditë burg për 20 Euro gjobë.

Gjykata të pandehurit i shqipton edhe **Dënimin Plotësues** – konfiskimin e pistoletës të markës “Ecol Tuna P.A.K” pa numër serik, e kalibrit 6mm, dy fishekë të kalibrit 7.62mm dhe 21 fishekë të pushkës së gjuetisë së kalibrit 12mm si dhe substancën narkotike të llojit “Marihuanë” në peshë rreth 9.9 gram, të sekuestruara nga ana e Policisë së Kosovës – NJHR në Gjilan.

I pandehuri detyrohet të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej (20) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan- Departamenti për Krime të Rënda, pranë kësaj gjykate, ka paraqitur aktakuzën PP.I.nr. 17/2018, të datës 05.02.2018, kundër të pandehurit, M.S. për shkak të dy veprave penale; mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 parag.1 të KPRK-së dhe posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 parag.1 të KPRK-së.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezentuar prokurori i shtetit, Agron Uka, i pandehuri M.S. të cilin e ka mbrojtur av.S.R. me autorizim.

Gjatë shqyrtimit fillestar të datës 09.02.2018, është lexuar aktakuza nga ana e prokurorit të shtetit dhe pas leximit të së njejtës, i pandehuri M.S., ka deklaraur se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprat penale të cilat i vëhen në barrë, duke deklaruar se e pranoj fajësinë për kryerjen e këtyre veprave.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtari pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajsisë, nga se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore në pajtim me nenin 248 parag. 1 të KPRK-së. Gjithashtu gjyqtari ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi është bërë vullnetarisht nga i pandehuri dhe se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe se e njejtja nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari ka vërtetuar gjendjen faktike; se te i pandehuri M.S., qëndrojnë të gjitha tiparet e veprave penale, në pajtim me dispozitivin I dhe II të aktakuzës me numër dhe datë të shënuar si më lartë, për çka edhe i njejtë është penalisht

përgjegjës, andaj gjykata të njejtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoj dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Bazuar në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit gjyqtari ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Me rastin e shqiptimit të dënimit, gjykata në rastin konkret ka gjetur rrethana lehtësuese të cilat tregojnë se edhe me shqiptimin e dënimit me gjobë dhe dënimit të kushtëzuar për të pandehurin M.S. si në dispozitiv të aktgjykimit, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 dhe 50 të KPRK-së.

Si rrethana veçanërisht lehtësuese për të pandehurit gjykata pati parasysh faktin se i njejtin e ka pranuar fajësinë për veprat penale të kryera, faktin se i njejtin është posedues i substancave narkotike edhe atë në bazë të analizës së “...” të datës 01.20.2018, të cilën e ka vërtetuar Dr.N.T.-A. specialiste e Biokimisë Klinike, pendimin, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të këtilla apo të ngjashme penale si dhe gjendjen e vështirë ekonomike të tij nga fakti se i njejtin është i papunësuar dhe mbajtës i katër anëtarëve të familjes.

Ndërsa si rrethanë rënduese për të pandehurin, gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale- rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale.

Me dënimin e shqiptuar ndaj të pandehurit, edhe atë duke marrë për bazë rrethanat e përmendura si më lart, gjykata konsideron se dënimi është i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprave penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata gjithashtu konsataton se me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 41 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale si dhe rehabilitimin e tij, parandalon personat e tjerë në kryerjen e veprave penale dhe shpreh gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe respektimin e ligjit.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 450 parag.1 dhe 2, pika 2.6 dhe 451 parag. 1 KPRK-së.

Konform nenit 69 parag.1 dhe 2 në lidhje me nenin 62 parag.1 dhe 2 nënparag.2.6 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet edhe **Dënimi Plotësues** - konfiskimi i pistoletës së markës “Ecol Tuna P.A.K” pa numër serik, e kalibrit 6mm, dy fishekë të kalibrit 7.62mm dhe 21 fishekë të pushkës së gjuetisë së kalibrit 12mm si dhe substancën narkotike të llojit “Marihuanë” në peshë rreth 9.9 gram, të sekuestruara nga ana e Policisë së Kosovës – NJHR në Gjilan.

Në bazë të të cekurave më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda
PKR.nr. 32/18 më 12.02.2018

Sekretare juridike,
Rafete Sylja, d.v.

Kryetari i trupit gjyqës
Islam Thaçi, d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.